ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E PODUJEVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **615-23-759-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me tabela digjitale mësimore**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	**SolvIT SH.P.K.**
NUI	**600871421**
Adresa	**Rr.Jusuf Gervalla Nr. 32**
Vendi	**PRISHTINË**
Kodi postar	**10000**
Numri Telefonit	**044905559**
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	**Ilirjan Miftari**
Adresa elektronike	**sales@solvit-ks.com**
Data e parashtrimit të ankesës	**24.03.2024**

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Furnizim me tabela digjitale mësimore

B05 Njoftimi për kontrate: 10.02.2023 ora 15:13

B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 15.02.2023 ora 10:49

B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara: 04.04.2023 ora 10:34

Dorëzimi i ofertave: 18.04.2023 ora 13:00

Njoftim mbi vendimi i autoritetit: 13.06.2023 ora 08:10

Kerkesa per Rishqyrtim 1: 17.06.2023

Refuzim i kerkeses per rishqyrtim: 23.06.2023

Dorezim i ankeses ne OSHP: 28.06.2023

Raporti i ekspertit te OSHP: 01.08.2023

VENDIMI 1 OSHP PER KTHIMIN E LENDES NE RIVLERSIM 23.08.2023

Pyetja e OE-se per AK dhe OSHP lidhur me mos Rivlersimin e aktivitetite nga OE

Njoftimi i 2-te per Anulim te aktivitetit nga AK: 22.09.2023

22.09.2023 22:17 - Kerkesa per rishqyrtim 2

27.09.2023 15:53 - Vendim mbi kerkesen per rishqyrtim (refuzim)

06.10.2023 09:33 - Vendimi per pezullim (ankese ne OSHP)

09.11.2023 - Vendimi i OSHP (Aprovuar, lenda kthehet ne rivleresim, TERHEQJA E VEREJTJES SE FUNDIT NGA OSHP PER AK)

07.03.2024 11:54 - Njoftim mbi vendimin e AK

09.03.2024 Kerkesa per rishqyrtim

14.03.2024 Vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ ***Jo*** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Ne kemi dërguar kërkesë për rishqyrtim me datën 09.03.2024 pranë AK-së, përderisa AK me datë 14.03.2024 ka marrë vendim për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

- Neni 1 (Qëllimi) i LPP Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (tutje: LPP)
- Neni 7 (Barazia në Trajtim/Jo-diskriminimi) i LPP Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092
- Neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) i LPP nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092
- Neni 30 i Rregullores për prokurim publik (tutje: RrPP).

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues gjatë udhëheqjes së procedurës së prokurimit dhe vlerësimit të ofertave për tenderin në fjalë, përkatësisht me Vendimin e datës 07.03.2024 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik Ne me datë 09.03.2024 kemi paraqitë kërkesën për rishqyrtim me argumentet e njëjta

sikurse në këtë ankesë. Me datë 14.03.2024 kemi pranuar vendimin e AK-së për refuzim.

1. **Shkelja 1 (veprimet e AK-së në kundërshtim me nenin 1, 7 dhe 59 të LPP-së dhe në kundërshtim me nenin 30 të RrPP-së)**

Arsyeja e eliminimit tonë e cekur në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar është se nuk kemi bërë zgjatjen e validitetit të ofertës duke u arsyetuar se na është dërguar një kërkesë e tillë. Mirëpo një kërkesë të tillë AK nuk e ka bërë konform nenit 30.4 të Rregullores për prokurim publik ku thuhet: citoj "*AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)".* Pra, fillimisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit (ZPP) bën shkelje procedurale duke mos përfillur aspektet procedurale të zbatimit të dispozitave të Rregullores.

Për të mos mjaftuar me kaq, AK me qëllim të arritjes së "qëllimit" të tyre, kinse e dërgon kërkesën përmes emailit. Duke qenë që ne nuk kemi pranuar një kërkesë të tillë ne kemi bërë qasje në dokumentet e tenderit për të parë emailin që na është dërguar është e qartë që në momentin që AK ka tentuar të na dërgojë email AK ka pranuar mesazhin kthyes nga serveri i e-mailave qeveritar (mail.rks-gov.net) ku shihet që emaili ka dështuar të dërgohet, në vijim e keni mesazhin e dështimit që AK na e ka vënë në dispozicion.

3/7/24, 3:19 PM Mail - prokurimi.podujeva@rks-gov.net

Undeliverable: Kerkese per zgjatjen e validitetit te ofertes

Mail Delivery System <Mailer-Daemon@mail1.rks-gov.net>

Fri 12/22/2023 1:45 PM

To:sales@solvit-ks.com <sales@solvit-ks.com>;

Delivery has failed to these recipients or groups:

sales@solvit-ks.com

A problem occurred while delivering your message to this email address. Try sending your message again. If the problem continues, please contact your email admin.

Diagnostic information for administrators:

Generating server: mail1.rks-gov.net

sales@solvit-ks.com
Remote Server returned '554 5.0.0 < #5.0.0>'

Original message headers:

```
Return-Path: <prokurimi.podujeva@rks-gov.net>
Received: from exmbx8-c.irk.rks ([10.153.230.53]:50232 helo=mail.rks-gov.net)
        by mail1.rks-gov.net with esmtps  (TLS1.2) tls TLS_ECDHE_RSA_WITH_AES_256_CBC_SHA384
        (Exim 4.96)
        (envelope-from <prokurimi.podujeva@rks-gov.net>)
        id 1rFu3q-0007bf-0G
        for sales@solvit-ks.com;
        Wed, 20 Dec 2023 11:44:22 +0100
```

Pra është e qartë dhe e faktuar se AK në vend që të sigurohet që kërkesa ka arritur tek ne, është njoftuar që kërkesa nuk ka arritur asnjëherë dhe nuk ka ndërmarr asnjë veprim. Përkundër kësaj, ne kemi bërë vazhdimin e sigurimit të tenderit dhe zgjatjen e validitetit të ofertës. Kjo praktikë e vendosur nga AK duke anashkaluar procedurën ligjore të kërkesës për zgjatjen e vazhdimit të sigurimit dhe validitetit është kthyer në një praktikë të kundërligjshme nga AK si metodë për të ardh deri tek përzgjedhja e OE-ve të preferuar nga AK, metodë kjo e cila vërehet edhe në aktivitete tjera që kanë qenë objekt trajtimi edhe në OSHP.

Si përfundim, AK me dashje ka vepruar në kundërshtim të zbatimit të dispozitave të LPP dhe RrPP pasi që e kishte te qartë që një kërkesë e tillë duhet të bëhet përmes platformës, dhe përkundër që kishte informacion që nuk ka arritur kërkesa tek ne si OE që kemi dorëzuar tenderë në këtë aktivitet, e sheh këtë situatë si mundësi për të manovruar në qëllimin kundërligjor për të rekomanduar OE e preferuar në kundërshtim me rregullativën për prokurim publik.

Provë:

1) Njoftimi mbi vendimin i AK-së i datës 07.03.2024
2) Vendimi i AK për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i datës 14.03.2023.
3) Imazhi nga emaili i Zyrës së Prokurimit të AK-së

2. Shkelja 2 (veprimet e AK-së në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së duke rekomanduar për kontratë OE i cili nuk plotëson kërkesën me numër rendor 4 e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional)

Shkelja tjetër e AK-së në raport me kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional është në lidhje me autorizimin për produktin e ofertuar për pozicionin 3, ku në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit është kërkuar: "*OE duhet të ketë autorizim nga prodhuesi apo distributori për produktet e ofruara* " Dëshmia e kërkuar për këtë kërkëse është: *"Autorizimi i nënshkruar dhe i vulosur nga prodhuesi apo distributori ne emer të Operatorit ekonomik efertues*"

Pra është e qartë që AK ka kërkuar autorizim për të gjitha produktet sipas pozicioneve të dosjes së tenderit. OE i rekomanduar për kontratë për pozicionin 3 ka ofertuar me një produkt për të cilin nuk ka dorëzuar autorizimin sipas kërkesës. Rrjedhimisht OE i rekomanduar ka dështuar të plotësoj kërkesën në lidhje me autorizimin sipas dosjes së

tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Provë:

4) Njoftimi për kontratë
5) Dosja e tenderit
6) Produkti i ofertuar nga OE i rekomanduar për pozicionin 3

3. Shkelja 3 (veprimet e AK-së në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së duke rekomanduar për kontratë OE i cili nuk plotëson kërkesën me numër rendor 1 e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional)

AK përmes vendimit të datës 07.03.2024 ka rekomanduar për shpërblim me kontratë OE: Bak ING -SHPK. Pasi kërkesës për qasje në dokumentet e tenderit të OE të rekomnaduar kemi vërejtur se ky OE nuk plotëson kërkesën e njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit lidhur me kapacitetin teknik dhe profesional ku është kërkuar: "*Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjajshme në vlerë minimale prej 450,000.00 Euro, në 3 (tre) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë).*" Dëshmia e kërkuar për këtë kërkëse është: *"Një listë të kontratave të realizuara, duke plotësuar Aneksin 6 të Dosjes së Tenderit ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën e kontratës, datën e fillimit dhe datën e përfundimit dhe përfituesin, si dhe listës ti bashkëngjiten referencat ose certifikatat për kryerje të furnizimeve*."

Ndërsa, OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar kontratat dhe referencat që absolutisht nuk kanë të bëjnë me fushën e Teknologjisë Informative – TI, e lerë me aktivitetin specifik-Tabela(Smarboard) Digjitale. Kontratat e përfunduara nga ky OE kane qene kryesisht furnizime me material elektrik (siguresa, reflektor e material hargjues elektrik, kabllo, lampa eti). Për me shumë kontratat dhe referencat kanë kode tjera të fjalorit të përbashkët të prokurimit (FPP) në raport me këtë aktivitet të prokurimit. Kodi i FPP për këtë aktivitet të prokurimit është 32000000-3 -Radio, televizion, komunikim, telekomunikacion dhe pajisjet dhe aparatet e ngjashme, ndërsa të gjitha kontratat e prezantuara janë me kode elektrike dhe të ngjashme.

Në vijim mund të shihet lista e kontratave dhe referencave:

Name

Furnizim me material hanxhues elektrik (KEKO-20-317-121)

Furnizim me kabllo energjetike, kabllo per elektromotor dhe konvertor te frekuencave

Furnizim me material elektrik (NPB)

Furnizim me materjal hanxhues elektrik

Furnizim me materjal per ndriqim

Furnizim me pjese per PLC

Furnizim me shëndrrues të frekuencave

Furnizimi dhe montimi i nderpreresave te fuqise - LOT 1

Furnizimi me njesi kontrolluese

Furnizimi me reflektor LED

Komuna e Gjakoves

Lista e referencave

Raporti i pranimit për projektin Furnizim me Modema xDSL

Raporti i pranimit te situacionit te parë (I-rë) dhe të fundit për projektin Furnizim me material esencial elektrik për SHKK-në

Raporti i pranimit te situacionit te parë (I-rë) dhe të fundit për projektin Rregullimi i ndriçimit dhe zëvendësimi i poçave me efiçiencë në institucionet e SHKK

Andaj, si përfundim, sipas sqarimeve të mësipërme provohet se kontratat dhe referencat nuk kanë të bëjnë me fushën e TI-së rrjedhimisht nuk plotësohet kërkesa me numër rendor 1 e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional.

Provë:

7) Imazhi nga lista e kontratave dhe referencave të OE të rekomanduar

4. Shkelja 4 (veprimet e AK-së në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së duke rekomanduar OE i cili nuk plotëson specifikimet teknike të dosjes së tenderit – Aneksi 1 specifiket teknike të detyrueshme)

OE ka rekomanduar për kontratë ka ofertuar me pajisjen e cila nuk përmbushë specifikimet teknike të detyrueshme të vendosura nga AK në dosjen e tenderit, përkatësisht Aneksin 1 -specifikimet teknike të detyrueshme.

Në vijim po e paraqesim në formë tabelore krahasimin e specifikimeve teknike të kërkuara dhe specifikimet teknike të pajisjes së ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë, ku faktohet se së paku në 5 pozicione nuk plotësohen specifikimet teknike të detyrueshme.

Nr.	**Specifikimi i kërkuar sipas dosjes së tenderit Aneksit 1.**	**Specifikimi teknik i produktit të ofertuar (mungesat)**
1	Portet Hyrse: ..... Android USB-A 2.0 x 1,	Produkti i ofertuar nuk ka fare port: Android USB-A 2.0 x 1
2	Portet Hyrse: ..... Analog MIC x 1	Produkti i ofertuar nuk ka fare port: Android USB-A 2.0 x 1
3	Shfletues vebi: PO	Produkti i ofertuar nuk ka fare shfletues uebi.
4	Biblioteka e aplikacioneve: PO	Produkti i ofertuar nuk ka fare biblotekë të aplikacioneve.
5	Multi writing: Max 20 points (Windows – Android)	Produkti i ofertuar nuk përkrah fare Multi-Writing.

Provë:

8) Dosja e tenderit – Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme

9) Broshura e produktit të ofertuar të OE të rekomanduar për kontratë

<u>Përfundimi</u>

Ne vazhdimësi kemi vërejtur tendencën nga AK për ta prolonguar dhe anuluar këtë aktivitet, dyshimet tona qëndrojnë tek mos përzgjedhja e fituesit te preferuar duke vepruar në kundërshtim me parimet dhe dispozitat e legjislacionit për prokurim publik në Kosovë.
AK qëllimshëm dhe me vetëdije ka tentuar gjithashtu te mos respektoj edhe vendimet e OSHP-se, prandaj zyrtaret kanë marre Vërejtjen e fundit para marrjes se masave Disiplinore ndaj zyrtarëve te prokurimit ne vendimin e OSHP-se: 2023/0763 te datës 09.11.2023 ku thuhet. "*Prandaj, Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që te njëjtit te jene te vëmendshëm gjate procedurave te prokurimit publik duke respektuar dhe duke vepruar në përputhje te plote me LPP dhe legjislacion tjetër ne fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me te gjeturat e vendimit Nr. 438-448/23 te datës 23.08.2023. Ngase nëse evidentohen sërish shkelje te tilla nga AK, OSHP bazuar ne nenin 104 dhe 105 lidhur me nenin 25 paragrafi 9 t& LPP nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, do ta kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtareve përgjegjës te prokurimit. Kjo konsiderohet si vërejte përfundimtare.*"

Andaj, kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe Paneli Shqyrtues i OSHP-së që krahas vendimit meritor në lidhje me pretendimet, konform nenit 97, paragrafi 1, pikat f, g dhe o, të iniciohet revokimi i certifikatës për ZPP sikurse përcaktohet në nenin 91, paragrafi 1, pika b.

Kërkesa

Bazuar ne dispozitat ligjore, argumentet si dhe provat e bashkangjitura është vërtetuar se autoriteti kontraktues ka marr një vendim i cili ka shkelje te theksuara procedurale, materiale si dhe ka konstatim te gabuar te gjendjes faktike. Andaj, si parashtrues i ankesës, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, të vendos në mënyrë meritore lidhur me këtë çështje dhe te nxjerrë këtë:

VENDIM

I. APROVOHET Ankesa e SOLVIT Sh.p.k e paraqitur ndaj Vendimit te Autoritetit Kontraktues Komuna e Podujevës, si e BAZUAR;

II. ANULOHET Vendimi i Autoritetit Kontraktues Komuna e Podujevës datë 07.03.2024, si i KUNDERLIGJSHEM;

III. OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues-Komuna e Podujevës qe SOLVIT Sh.p.k ta përfshijë në vlerësimin e ofertave.

IV. REVOKOJË certifikatën profesionale të prokurimit për ZPP të Autoriteti Kontraktues-Komuna e Podujevës.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale perfshijne pergaditjen e ofertes perfshi kosoton e sigurimit, konsulencen ligjore per 3 kerkesa per rishqyrtim dhe 3 ankesa ne OSHP, fitimi i humbur dhe kostot operative.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*